



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**K.DH.Shk II.nr. 1684/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**-Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbareme të kreditorit NNT Kosova Ehr&Kotori SH.P.K me numër unik identifikues 70504472 me seli në Prizren, Rr. Ismail Kryeziu nr.80, të cilën në përfaqëson E.H., kundër debitorit Trepça Sh.A, me seli në Mitrovicë, me bazë juridike përmbareme, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.851/21 të datës 12.04.2022, me datë 25.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit Trepça Sh.A, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, KPPP.nr.851/21 të datës 12.04.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.851/21 të datës 12.04.2022, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” Sh.A., me seli në Mitrovicë ndaj Urdhrit Përmbareme P.nr. 1231/2021, i lejuar me datë 03.06.2021, nga Përmbaremi Rushit Hoxha dhe Urdhri Përmbareme P.nr. 1231/21 i lejuar me datë 03.06.2021, nga Përmbaremi Rushit Hoxha mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi Gjykatës Themelore në Mitrovicë, KPPP.nr.851/21 të datës 12.04.2022.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjyqtari individual i Gjykatës Themelore në Mitrovicë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NNT Kosova Ehr&Kotori SH.P.K me seli në Prizren, me dt. 03.06.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim mbi bazën e dokumentit të besueshëm; Faturave Nr.13/2020 dhe Nr.14/2020 të faturës 22.09.2020 t'ia paguaj shumën prej 11,880.00, me kamat ligjore në lartësinë prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe atë nën kërcënimin e ekzekutimit, të dhunshëm, mjetet e mbledhura nga llogaria e debitorit të barten në llogarinë e kreditorit e pastaj në atë të kreditorit të gjitha këto të specifikuar në propozim për përmbartim të dt. 03.06.2021. Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësimin me shkrim duke kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues nuk janë të përshtatshëm për përmbartim sepse në këto fatura nuk është cekur koha e përmbushjes së detyrimit dhe nuk ka arritur afati për pagesë. Andaj i propozojmë gjykatës që të anulohet urdhrin përmbartimor. Po ashtu kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar, sepse kreditori propozimin për përmbartim e ka ngritur konform dispozitave të nenit 71 të LPP-së dhe qëllimi i debitorit në prapësimin e parashtruar është vetëm prolongim i procedurës përmbartimore. Andaj i propozon gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pa bazuar.

Gjykata Themelore në Mitrovicë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që

gjinden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit. Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe nuk tregon shkaqet sikurse në nenin 69 dhe 71 të LPP-së, sipas të cilave do të pengohej përbarimi i lejuara nga kjo gjykatë, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si të pa bazuara pasi që në shkresat e lëndës shihet se propozimi për përbarimi është ngritur duke u bazuar në dispozitat e ligjit të procedurës përbarimore dhe at konform nenit 38 par 1 të LPP-së. Propozimi për përbarim duhet të përbaroj kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar apo dokumenti i besueshme në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitorit, adresa e vendbanimit-vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit, po ashtu propozimi për përbarim është ngritur duke u bazuar edhe në nenin 21 lidhur me nenin 29 par.1 nën par.1.3 dhe par.3 të LPP-së. Ndër të tjera ka cek se lidhur me pretendimet e debitorit i cili ka kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetimin se kreditori në faturat e tij nuk ka paraparë afat brenda të cilit duhet ta bëjnë pagesën e borxhit, të njëjtat gjykata i refuzoj si të pa bazuara për faktin se duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht në Kontratën NR ST/KHA-047/2020, në të njëjtën parashihet edhe periudha kohore brenda të cilit debitori ka qenë i obliguar për përmbushjen e kontratës konform kontratës kreditori e ka lëshuar faturën e të cilën e ka pranuar debitori, ashtu që në faturën e lëshuar e të pranuar nga ana e debitorit është përfshi periudha kohore e pranimit dorëzimit të mallit si dhe pagesat që duhet të bëhen konform të njëjtës, po ashtu ka cek se Gjykata e shkallës së parë thekson se kreditori i obligohet debitori si në propozim për përbarim këtë fakt gjykata e mbështet në nenin 245 par.1 të LMD-se i cili nen parasheh se Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyre ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij, ndërsa par 2. i po të njëjtit nen parasheh se kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkoj edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak. Po ashtu neni 249.1 të LMD-se parasheh se kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur të cilat debitori është dashur ti parashikonte detyrimisht në kohën e lidhje se kontratës si pasoja të mundshme të shkeljes se kontratës e duke marr parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht ti kishte të njohura, ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh se në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë

së rëndë kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori shpërblimin e tërë dëmit i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur rrethana të veçanta për shkak të cilave janë shkaktuar ato. Ndërsa sa i përket kamatës së aplikuar, gjykata iu referua nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata Komerciale -Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Gjykata Themelore në Mitrovicë , në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin i gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g, j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se me drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK- së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, e të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, e të cilat janë të pranuar nga debitori dhe të vërtetuar tek noteri, dhe se pranimi i të njëjtave nënkupton që debitori ka pranuar detyrimin që buron nga faturat, kështu si e till paraqetë bazë juridike për caktimin e përmbartimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së, andaj, Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve të kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Po ashtu kjo Gjykata mori parasysh edhe pretendimet e debitorit lidhur me at se faturat nuk janë në origjinal por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi që faturat në fjalë janë të vërtetuar tek noteri Orhan Gashi, i cili vërtetim është nxjerr nga dokumenti origjinal.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.Sh.II.nr. 1684/23 me datë 25.03.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri